

VENDIM
Nr. 101, datë 20.3.2023

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
APLIKIMIN E SHOQËRISË “SUN ENERGY SOLUTIONS” SHPK PËR LICENCIM
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 571/6 prot., datë 17.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 20.2.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.2.2023 dhe 22.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 571/3 prot., datë 3.3.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 571/4 prot., datë 7.3.2023.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të zhvilluar një korrespondencë të mtejshme me shoqërinë për të sqaruar dokumentacionin që duhet të depozitohet, në kuadër të këtij aplikimi e po ashtu formën e depozitimit të tyre, vlerësohet të zgjatet deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti